



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 3368 Prot.

Vau Dejës me 10 / 06 / 2022

PROJEKT VENDIM

PËR:

“ Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z. Agim Sulejmani”

Komisioni i mandateve të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49, pika 2, pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI:

1. Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z. Agim Sulejmani, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49, pika 4 germa (e) për shkak se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës për një periudhë 6 mujore.

Kryetari Këshillit

Mark Bisha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

RELACION

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 49, pika 4, germa e, dhe në rregulloren nr.23 datë 24.04.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës" neni 21, pika 1, germa g, ju raportoj si më poshtë:

Këshilltari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Z. Agim Sulejmani (përfaqësuese e subjektit politik P.S.D) nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për një periudhë 6-mujore rresht, dhe konkretisht: Nga mbledhja e muajit Dhjetor 2021 deri në mbledhjen e muajit Maj 2022. Sqaroj se Këshilli Bashkiak Vau Dejës ka zhvilluar mbledhje normale të rradhës për ç' do muaj si më poshtë:

Mbledhja e muajit Dhjetor është bërë me datë 23.12.2021.

Mbledhja e muajit Janar është bërë me datë 26.01.2022.

Mbledhja e muajit Shkurt është bërë me datë 25.02.2022.

Mbledhja e muajit Mars është bërë me datë 28.03.2022.

Mbledhja e muajit Prill është bërë me datë 29.04.2022.

Mbledhja e muajit Maj është bërë me datë 26.05.2022.

Në të gjitha këto mbledhje të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Këshilltari Z. Agim Sulejmani ka munguar pa shprehur ndonjë arsye.

Sa më sipër :

Kryetari Këshillit

Mark Bisha

